

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik dhe ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik të kategorisë “Lektor” në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë

Kritere përcaktuese

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike, drejtim Energjitik ose studimet e ciklit 5 vjeçar në Inxhinieri Elektrike.
2. Nota mesatare (ose e ponderuar) e diplomave të studimit të jetë mbi 8.0.
3. Të zotërojë një gjuhë të huaj me dëshmi (preferohet anglisht).
4. Të ketë mbrojtur gradën shkencore “Doktor” në fushat e studimit të departamentit (Elektroenergjitik).

Kritere të tjera

1. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor në fushën përkatëse.
2. Preferohet të ketë qenë drejtues dhe pjesëmarrës në projekte të ndryshme.
3. Të ketë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.
4. Titulli përbën avantazh.

B. 1 (një) vend pune për personel ndihmës akademik në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë

Kritere për personel ndihmës akademik

Kritere përcaktuese

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë Master në Inxhinieri Elektrike, drejtim Energjitik ose studimet e ciklit 5 vjeçar në Inxhinieri Elektrike, drejtim Energjitik.

Kritere të tjera

1. Preferohet të ketë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjitik.
2. Preferohet të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet anglisht).
3. Preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor.
4. Të ketë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **12.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.